



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6987/2021
Data: 13.09.2021

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 24.08.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetarë i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtore për Buxhet e Financa), Zaim Bela (Drejtore për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Menduh Vlashi (Drejtore për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2021.
3. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.
4. Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
5. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2020.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020-2021.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Mehmet Ballazhi thekson:- në raport është një përsëritje e punës së kryetarit të komunës. Në raport i lexova disa takime të cila janë bërë dhe janë vetëm sipërfaqësisht takim pa ndonjë sqarim. Kërkoj sqarim për projektin e shtratit të lumit Lepenc.

Rufki Suma thekson:- këtë projekt e kemi pasur si plan që nëse kemi mundësi me gjetur donatorë me mundur me rregulluar shtratin e lumit Lepenc. Para pandemisë është diskutuar me realizuar këtë projekt përmes Bankës Botërore me të cilën janë zhvilluar tri apo katër takime. Takimin që e kemi pasur me zëvendës ministrin z. Hysen Durmishi kam potencuar se nëse e realizon këtë projekt Ministria shumë më lirë do të bëhet se sa përmes Bankës Botërore për shkak se nëse shkohet me kredi ka një kosto më të lartë. Takimet që bëhen shënohen vetëm shkurtë. Çështja e përsëritjes dashtëm apo nuk dashtëm përsëriten si takimet e rregullta të bordit, KKSB-së dhe vetë puna e komunës është e njëjtë përveç ndryshimit të projekteve të cilat realizohen.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- duke e parë situatën në bazë të tenderëve të shpallura për projektet kapitale e kemi parë të nevojshme me bërë një rialokim apo transfere të mjeteve për shkak se nga Qeveria është bërë rishikimi i buxhetit.

Rialokohen në projektet:

“Mjete të lira për bashkëinvestime”, kodi (41641) në shumë prej 5,000.00 €;

“Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve rurale në Han të Elezit”, kodi (48910) në shumë prej 22,452.49 € .

Transferi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (10),

Nga programi Planifikimi urban dhe mjedisi (660), nën-programi (66480), kodi funksional (0620), transferohen mjetet nga projektet:

“Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike në zonat urbane dhe zonat rurale”, kodi (45772) shuma prej 20,000.00 €;

Nga programi Arsimit dhe shkenca (920), nën-programi (92175), kodi funksional (0721), transferohen mjetet nga projektet:

“Ndërtimi i sallave sportive në Paldenicë dhe Gorancë”, kodi (41675) shuma prej 4,539.00 €;

“Pajisja e kabineteve me mjete mësimore dhe laboratorike”, kodi (44179) shuma prej 2,126.00 €;

Në programin / nën-programin Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjenca (180), nën programi (18444), kodi funksional (0320) transferohen mjetet në projektin si vijon:

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”, kodi (47216) në shumë prej 26,665.00 €;

Transferi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (21).

Nga programi Planifikimi urban dhe mjedisi (660), nën-programi (66480), kodi funksional (0620), transferohen mjetet nga projekti:

“Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik”, kodi (47270) shuma prej 2,547.51 €;

Në programin / nën-programin Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjenca (180), nën programi (18444), kodi funksional (0320) në projektin si vijon:

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”, kodi (47216) në shumë prej 2,547.51 €.

Arsyetim:

Ky rialokim dhe transfer i mjeteve kërkohet që të miratohet nga kuvendi i komunës për shkak se pas procedurave të prokurimit nga shpallja e tenderëve, marrëveshjeve të bashkëfinancimit dhe nënshkrimi i kontratave me operatorët ekonomik të disa projekte kapitale vlera e kontraktuar ka rezultuar të jetë më e vogël se vlera e planifikuar dhe e buxhetuar për ato projekte, prandaj është kërkuar që të bëhen rialokimet/transferet e propozuara më lartë.

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (10),

Në kuadër të programit Shërbimet Publike, mbrojtja civile dhe emergjenca (180), nën-programi (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej 3,403.00 €.

Rialokohen nga projektet:

“Ndërtimi i rezervarit të ujësjellësit në fshatin Gorancë”, kodi (51001) shuma prej 3,154.00 €;

“Ndriçimi publik në zonat urbane dhe rurale”, kodi (90573) shuma prej 249.00 €;

Rialokohen në projektin:

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”, kodi (47216) në shumë prej 3,403.00 €.

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (10),

Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660), nën-programi (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 5,000.00 €.

Rialokohet nga projekti:

“Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike në zonat urbane dhe zonat rurale, kodi (45772) shuma prej 5,000.00 €;

Rialokohet në projektin:

“Mjete të lira për bashkëinvestime”, kodi (41641) në shumë prej 5,000.00 €;

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (21),

Në kuadër të programit Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjenca (180), nën programi (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej 15,000.00 €.

Rialokohen nga projektet:

“Fond për emergjencë”, kodi (41620) shuma prej 5,000.00 €,

“Participim për projektet me Efijencë të energjisë”, kodi (51010) shuma prej 10,000.00 €,

Rialokohen në projektin:

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”, kodi (47216) në shumë prej 15,000.00 €;

Ri-alokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (21)

Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660), nën-programi (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 27,452.49 €.

Rialokohen nga projektet:

“Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në zonat urbane dhe rurale”, kodi (49987) shuma prej 10,000.00€;

“Ndërtimi i mureve mbrojtëse nëpër zonat urbane dhe rurale”, kodi (50146) shuma prej 5,000.00 €;

“Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha" (asfaltim, trotuar, ndriçim publik, gjelbërim)”, kodi (51085) shuma prej 10,000.00 €;

“Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik”, kodi (47270) shuma prej 2,452.49 €;

Mehmet Ballazhi thekson:- është një keq planifikim i projekteve por edhe përgjithësimi i projekteve ju e dini që ka qenë edhe rekomandim prej auditorit për me i precizuar projektet. Te ndërtimi i mureve mbrojtëse jemi zero zero nëse miratohet ky rialokim , nuk ka për vitin 2021 rregullim të përrrockave dhe kanalizimeve atmosferike , nuk ka rregullim të trotuareve dhe ndriçim publik , gjelbërime publike nuk ka , nuk ka asfaltim të rrugës Gorancë-Krivenik.

Rufki Suma thekson:- çdo herë bëhen planifikimet nëse mendojmë që gjejmë donatorë dhe rastin konkretë e kemi rregullimin e parkut “Isa Berisha” se tash jemi duke e hequr por ka gjasa që për mbledhje të kuvendit me pasur ndryshim. Nga Ministria e Pushtetit Lokal ka kërkuar që komuna të dërgon kërkesa urgjente për ndonjë projekt që ka të bëjë kryesisht me parqe dhe e kemi dërguar si kërkesë këtë projekt.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse miratohet ky rialokim mjete financiare për këtë projekt nuk kemi jemi zero zero dhe nëse kalon ky projekt nuk besoj që kemi kohë që me marr vendim tjetër dhe po më duket që jemi duke punuar paushall sepse planifikimi është tjetër gjë. Nëse është dërguar kërkesa është mirë që së paku këtë pjesë mjeteve financiare mos ta heqim.

Rufki Suma thekson:- ne mendojmë që deri në mbledhje të kuvendit të komunës me bërë këtë sepse besoj që do të vendosin shpejtë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KËRKESA PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE FINANCIARE NË KATEGORINË EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- zyra kombëtare e ka bërë auditimin për komunën e Hanit të Elezit dhe opinionin e tyre është i pa modifikuar për pasqyrat financiare sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Hanit të Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Kemi pasur një theksim të çështjes për pagesat e bazuar në vendime gjyqësore në shumë prej 4,124 € ishin paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Këto pagesa ishin për tri paga përcjellëse të dala nga marrëveshja kolektive e arsimit, të cilat ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Për vitin 2020 kanë qenë dy rekomandime njëri te tatim në pronë që komuna për çdo vit duhet të bënë së paku 20% verifikim të tatimit në pronë të pronave brenda territorit të komunës. Për shkak të pandemisë vitin e kaluar nuk kemi mundur me bërë 20% të verifikimit të pronave. Vitin e kaluar kemi pasur vendimin për me punuar me staf të reduktuar por ata kanë vendosur me dhënë këtë rekoamndim. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me pasuritë nën 1000 € që përmes sistemit me i regjistruar por sistemi nuk ka qenë funksionalë dhe kanë sugjerua të veprohet në forma të tjera. Në vitin 2019 i kemi pasur shtatë rekoamndime dhe për ato shtatë rekoamndime është përgatitur plani i veprimit dhe pesë rekoamndime i kemi zbatuar, një nuk aplikohet më dhe njëri është pjesërisht

Mehmet Ballazhi thekson:- sistemi i epasurisë edhe vitin 2019 ka qenë i njëjti problem dhe na ka përcjellë edhe në vitin 2020 dhe në vitin 2021.

Shabi Rexhallari thekson:- jemi në kontakte me të USAID-it të cilët e kanë përcjell një model dhe besoj që do të shkon mirë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- është formuar komisioni për verifikimin e 20 % të objekteve të paluajtshme dhe ka filluar dalja në teren për verifikim të pronave dhe një kohësisht edhe raportimi në formën eksell në mënyrë që me vërtetuar se sa ka arritur. Në plan janë paraparë periudhat deri kur me i përfunduar rekomandimet. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RAPORTIN E AUDITIMIT NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020-2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATI MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2020-2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- në këtë vit të mbjellura me grurë kanë qenë 20 hektarë. Me datë 08.07.2021 ka filluar korrja dhe ka qenë vetëm një autokombaj dhe ka përfunduar me datë 27.07.2021. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- në këtë vit a ka të interesuar për me mbjellë apo janë të zhgënjyer.

Zaim Bela thekson:- mungesa e kombajit një prej arsyeve që në vitin e kaluar nuk kemi pasur dhe vitin e kaluar një fermer e ka blerë një kombaj për nevoja të veta por ju ka premtuar që do ta bëjë korrjen e grurit edhe fermerëve të tjerë të cilët mbjellin. Në këtë vit ende nuk e di gjendje për shkak se fermieri i cili e ka blerë kombajn ka deklaruar që nuk mundet me i korr për shkak se kombaji është i vjetër dhe po i shkakton defekt dhe ka mundësi që mos me mbjell.

Sabedin Hasallari thekson:- a ekziston mundësi që komuna me bërë një kontratë me ndonjë kompani e cila i ka kombajat më të mirë sepse rendimentet nuk kanë qenë të dobëta por për shkak të kombajtit që është i vjetër fermerët janë zhgënjyer.

Zaim Bela thekson:- kontratë ndoshta mundë të bëjmë por ata deklarojnë se për dy hektar nuk kemi llogari me ardhur. Autokombajnat duhet të jenë të terreneve më të vështira , mirëpo autokombajnat e vogla i kanë hequr krejt. Duhet të bisedojmë me fermat fillimisht se a janë të interesuar me mbjellë dhe nëse janë të interesuar komuna mundet me i subvencionuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR KORRJE SHIRJET QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- sa i përket gjendjes me koronavirus nga data 08.08.2021 deri dje i kemi 68 raste pozitiv në Han të Elezit . Deri më tani mbi 2500 qytetarë janë vaksinuar dhe prej tyre 40 % i kanë marr nga dy doza.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:57

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

